

## R A P O R T

### Hulumtim i Hapësirave Kulturore në Kosovë



MKRS

Raporti “Hulumtim i hapësirave kulturore në Kosovë” është pjesë e një serie të hulumtimeve të planifikuara në kuadër të Platformës “Kultura 2013”. Ky hulumtim kishte për qëllim identifikimin e hapësirave ekzistuese dhe nevojat e artistëve dhe organizatave për të ardhmen dhe njëherazi grumbullimin e të dhënave fillestar për hartimin e strategjive të mundshme për rritjen dhe përmirësimin e hapësirave kulturore.

Pyetësorët janë plotësuar nga perspektiva e Organizatave dhe Institucioneve që merren me veprimtari kulturore (pyetësori A) dhe nga perspektiva e artistit të pavarur (pyetësori B).

#### **I. Informatat e përgjithshme**

Në hulumtim kanë marrë pjesë 14 % femra dhe 86 % meshkuj si përfaqësues të organizatave dhe institucioneve kulturore, ndërsa nga perspektiva e artistit të lirë hulumtimit i janë përgjigjur 68.9 % meshkuj dhe 31.1 % femra. Nga ata 61.1% (47 %) janë pjesëmarrës të shoqërisë civile, 10 % (23 %) të administratës publike, 8.9 % (3 %) të bizneseve, 12.2 % studentë (5 %), 7.8 % (4 %) nxënës dhe të tjerë 18 %. Prej tyre 87.4 % (94.4 %) shqiptarë, 3.2 % (0.0 %) serbë, 3.2 % (2.2 %) boshnjakë, 4.2 % (2.2 %) turq, 2.1 % (1.1 %) RAE.

Mosha e të anketuarve është 11.16% (21.1%) 15-25 vjeçe, 26.3% (27.8%) të moshës 25-35 vjeç, 28.4 % (28.9%) të moshës 35-45 vjeç, kurse mbi moshën 45 vjeçe, 33.7 % (21.1%). Rreth 90% të anketuarve janë nga zonat urbane (75.8%) kurse 10% (24.2%) nga zonat rurale.

Shënim: Përqindjet në kllapa paraqesin rezultatet e anketimit të artistëve të lirë.

Pozita aktuale e personave të intervistuar është: 47.3% në pozitën e udhëheqësit ose drejtorit ekzekutiv të organizatës, pronar 4.4%, anëtar të bordit 12.1%, drejtor të bordit 1.1%, drejtor artistik 9.9%, menaxher 14.3%, asistent ose staf administrativ 7.7% dhe në pozita tjera 3.3% e të anketuarve.

Bazuar në statusin legal të subjekteve të anketuara, në hulumtim kanë marrë pjesë: 46.3% institucione publike, 38.9% OJQ, 11.6% organizata private, 1.1% organizata pranë universitetit dhe 2.1% me status tjetër.

Sipas fushave të veprimtarisë kulturore, rreth 22% të anketuarve si veprimtari primare e kanë teatrin (aktrim, regji, skenografi), rreth 16% artet mediale (film, video), artet pamore (pikturë, skulpturë, grafikë) rreth 16%, muzikë (këndim, kompozim) rreth 12.5%, edukim (shkollë arti, kurse profesionale) 10%, letërsi (prozë, poezi) rreth 5%, vallëzim, shfaqje, koreografi 5%, dizajn

(ueb, dizajn grafik, performansa multimediale) 4.2%, veprimtari tjera 2.2%, artizanati (argjendari, poçeri) 1.1% dhe dizajn mode 0.6%.

Shumica e institucioneve të anketuara janë themeluar para 6-10 vitesh, 32.6% e tyre. Të themeluara para 3-5 vite janë 22.1%, të themeluara para 1-2 vitesh 8.4%, dhe institucione rishtas të themeluara 2.1%. Të themeluara në fillim të viteve të '90-ta 1.1%, gjatë viteve të '90-ta 8.4%, para viteve të '90-ta 3.2%, me më shumë se 30 vite 13.7%, me më shumë se 40 vite 8.4%.

Sa i përket shkallës së punësimit me orar të plotë, 55.4% e organizatave dhe institucioneve të anketuara kanë nga 3-5 të punësuar, 16.9% kanë nga 5-7 të punësuar, 12.3% nga 7-10 të punësuar, 1.5% nga 10-13 të punësuar, 1.5% nga 13-15 të punësuar, 12.3% më tepër se 15 të punësuar. Me gjysmë orari apo me kontrata mbi vepër 51.6% e tyre kanë nga 3-5 të punësuar, 29% kanë nga 5-7 të punësuar, 9.7% kanë nga 7-10 të punësuar, 3.2% nga 10-13 të punësuar dhe 6.5% më tepër se 15 të punësuar. Në aspektin e përfaqësimit të femrës, 64.2% kanë 3-5 femra të punësuar në organizatën e tyre, 5.7% kanë 5-7 femra të punësuar, 9.4% kanë nga 7-10 femra të punësuar, 11.3% kanë 10-13 femra të punësuar, 1.9% kanë 13-15 femra dhe 7.5% kanë më tepër se 15 femra të punësuar.

Nga komunitetet etnike minoritare 3-5 veta janë të punësuar në 79.3% të organizatave të intervistuar, 7-10 veta në 3.4% të organizatave dhe më tepër se 15 veta kanë 17.2% e organizatave.

Mesatarisht 23.1% e organizatave angazhojnë 3-5 vullnetarë (pa pagesë), 18.5% angazhojnë 5-7 vullnetarë, 7.7% angazhojnë 7-10 veta, 9.2% angazhojnë 10-13 vullnetarë, 4.6% angazhojnë 13-15 vullnetarë, dhe më tepër se 15 vullnetarë angazhojnë 36.9% e organizatave.

Mesatarja vjetore e buxhetit në tri vitet e fundit është deri në 5000 € në 39% të organizatave, 5.000-10.000 € kanë 14.6% të organizatave, 10.000-15.000 € kanë 11% e organizatave, 20.000 - 50.000 € kanë 20.7% e organizatave, 50.000-100.000 € i kanë 6.1% e tyre, 100.000-300.000 € i kanë 7.3% e organizatave, 300.000-500.000 i kanë 1.2% e tyre.

Më shumë se gjysma e organizatave, pra 55% e tyre, nuk kanë hapësirë në pronësi të veten (25% kanë hapësirë të huazuar, 30% me qira) dhe vetëm 45% kanë hapësirë në pronësi të vetën.

Në objekte në pronësi private dhe me qira komerciale janë 31.7% e organizatave të intervistuar. Në objekte në pronësi private dhe me qira me të ultë se çmimi komercial janë 7.3%, në objekte në pronësi publike pa qira dhe shpenzime operacionale janë 17.1%, në objekte në pronësi publike dhe me qira të zbritur (të subvencionuar) janë 31.7%, në objekte në pronësi publike dhe me çmim komercial të qirasë janë 9.8%, dhe 2.4% janë përgjigjur se kanë një situatë tjetër.

Nga organizatat e intervistuar 20.5% shfrytëzojnë hapësirë deri në 50 m<sup>2</sup>, 30.1% nga 51-100 m<sup>2</sup>, 12% shfrytëzojnë 101-200 m<sup>2</sup>, 9.6% shfrytëzojnë 201-300 m<sup>2</sup>, 9.6% 301-500 m<sup>2</sup>, 2.4% 501-800 m<sup>2</sup>, 8.4% 801-1000 m<sup>2</sup>, 3.6% 1001-2000 m<sup>2</sup>, 2.4% 2001-5000 m<sup>2</sup>, 1.2% 5001-8000 m<sup>2</sup>.

Organizatrat që shfrytëzojnë hapësira me qira, 51.1% prej tyre, kanë kryesisht kontrata vjetore. Me kontrata mujore janë 19.1%. Kontrata me kohëzgjatje 1-2 vjet kanë 2.1%, 4.3% 3-5 vjet, 6.4% 3-10 vjet, dhe me kohëzgjatje të kontratës mbi 10 vjet 17%.

Në objektet me qira (pa i llogaritur mirëmbajtjen, taksat dhe obligimet tjera) 30% e organizatave paguajnë qira mujore nga 50-100€, 20% e tyre nga 100-150€, 20% e tyre nga 150-

200€, 13.3% nga 200-250€, 3.3% nga 250-300€ dhe qira mujore mbi 500€ paguajnë 13.3% e organizatave.

Brenda 6 muajve kontrata aktuale për shfrytëzimin e hapësirës përfundon për 33.3% të organizatave, pas një viti përfundon për 50% të organizatave, 1-2 vite nga tani për 5.6%, 3-4 vite nga tani për 5.6% dhe mbas 5 viteve përfundon për 5.6% të organizatave.

Organizatave që kanë mundësi të lëshojnë pjesë të hapësirës në shfrytëzim 57.1% e ofrojnë atë me çmim prej 50-100€ për ditë të shfrytëzimit, 17.1% 100-150€ për ditë të shfrytëzimit, 8.6% 150-200€, 8.6% 200-250€, 2.9% 250-300€, 5.7% me çmim mbi 500€. Aktualisht, këto hapësira huazohen deri në 10% të kohës gjatë vitit për 38.6% të organizatave, 10-20% të kohës për 27.3% të organizatave, 20-30% për 11.4% të organizatave, 30-40% për 2.3% të organizatave, 40-50% për 6.8% të organizatave dhe mbi 50% të kohës për 13.6% të organizatave.

Organizatave që kanë hapësirë në pronësi të veten deklarojnë se vlera e qirasë mujore që e shfrytëzojnë për ushtrimin e veprimtarisë është 50-100€ për 22.2% të tyre, 100-150€ për 17.8% të tyre, 150-200€ për 13.3% të tyre, 200-250€ për 2.2%, 250-300€ për 15.6%, 450-500 për 6.7%, dhe mbi 500€ do të ishte vlera e qirasë mujore për 22.2% të organizatave. Pjesa më e madhe e organizatave që kanë hapësirë në pronësi të veten, 70.3% e tyre, deklarojnë që i kanë mbuluar (kthyer) investimet fillestare, 13.5% i kanë mbuluar gjysmën e investimeve, ndërsa 16.2 nuk i kanë mbuluar investimet fillestare.

5.1% e organizatave që shfaqin para publikut deklarojnë se kapaciteti i hapësirës së tyre është i plotësuar vetëm deri në 10%. 12.7% deklarojnë se kapaciteti i tyre është i plotësuar 10-30%, ndërsa 30-50% të kapacitetit është e plotësuar në 22.8% e organizatave, 50-70% në 19% të organizatave, 70-90% në 22.8% e organizatave, 15.2% e organizatave i shfrytëzojnë 100% kapacitetet veta hapësinore dhe vetëm 2.5% thonë se ka interesim më të madh të publikut se sa mbulojnë kapacitetet e tyre aktuale.

Nga organizatat që nuk kanë hapësirë të mjaftueshme kulturore për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, 31.8% deklarojnë që asnjëherë nuk huazojnë hapësirë, 16.5% huazojnë rrallë, 18.8% nganjëherë, 11.8% shpesh, 8.2% shumë shpesh dhe 12.9% gjithnjë.

Hapësirat publike joformale (që nuk janë ekskluzivisht të destinuar për veprimtari kulturore) nuk shfrytëzohen fare nga 59.5%, shfrytëzohen rrallë nga 19%, nganjëherë nga 11.4%, shpesh nga 7.6%, shumë shpesh nga 1.3% e tyre dhe rregullisht (gjithnjë) nga 1.3% e organizatave.

Ndërsa hapësirat publike formale që janë ekskluzivisht të destinuar për veprimtari kulturore (siç janë teatri, salla e kulturës) del se shfrytëzohen me shpesh se hapësirat joformale sepse 13.1% i shfrytëzojnë gjithnjë, 7.1% shumë shpesh, 22.6% shpesh, 11.9% nganjëherë, 9.5% rrallë dhe 35.7% asnjëherë. Kurse, hapësirat komerciale që nuk janë ekskluzivisht të destinuar për veprimtari kulturore shfrytëzohen shumë pak. 71.8% asnjëherë, 11.3% rrallë, 11.3% nganjëherë, 4.2% shpesh, 1.4% shumë shpesh.

Një hapësirë prej 200-500 m<sup>2</sup> për një orë shfrytëzimi, 28.8% e deklarojnë që mund të kontraktohet për një shumë deri në 50€, 43.9% 50-100€, 12.1% 100-200€, 13.6% 200-500€, 1.5% mbi 500€.

Hapësirat publike të dedikuara për prezantime kulturore, nga 20.9% vlerësohen si hapësira që aspak nuk i plotësojnë nevojat, nga 49.5% pjesërisht i plotësojnë nevojat, 17.6% vlerësojnë që i plotësojnë nevojat, 4.4% plotësisht i plotësojnë nevojat dhe 7.7% deklarojnë që nuk i shfrytëzojnë fare hapësirat publike.

Hapësirat administrative, për 21% të organizatave të anketuara aspak nuk i plotësojnë nevojat, për 35.6% pjesërisht i plotësojnë nevojat, për 17.8% i plotësojnë nevojat, për 4.4% plotësisht, dhe 21.1% nuk shfrytëzojnë hapësira administrative. Hapësirat për ushtrime dhe përgatitje të produktit kulturor, për 19.5% aspak nuk i plotësojnë nevojat, për 48.3% pjesërisht i plotësojnë nevojat, për 13.8% i plotësojnë nevojat, për 4.6% plotësisht i plotësojnë nevojat dhe 13.8% nga ta nuk shfrytëzojnë hapësira të tilla. Hapësirat për trajnime dhe organizim të punëtorive, nga 23.3% vlerësohen që aspak nuk i plotësojnë nevojat, 35.6% thonë se pjesërisht i plotësojnë nevojat, për 16.7% i plotësojnë nevojat, për 3.3% plotësisht i plotësojnë nevojat dhe 21.1% nuk shfrytëzojnë hapësira të tilla.

Të pyetur se si kanë ndikuar politikat e privatizimit në situatën e politikave kulturore, 6.6% kanë vlerësim pozitiv, 22% kanë vlerësim negativ dhe 71.4% mendojnë se s'ka ndikim fare.

Fleksibiliteti i hapësirës për 57.4% të organizatave konsiderohet si me rendësi, për 33% me shumë rendësi, i dëshirueshëm për 6.4%, dhe për 2.3% është krejt i parëndësishëm. Mundësitë e shfrytëzimit të hapësirës vlerësohen të jenë shumë të rëndësishme për 50% të organizatave, me rendësi për 42.6% dhe për 7.4% të dëshirueshme. Kapaciteti i hapësirës, për 29.8% vlerësohet si me rendësi, nga 62.8% vlerësohet si më shumë rendësi dhe 7.4% si e dëshirueshme.

Mundësitë e pronësimit eventual, për 34.8% konsiderohen si të parëndësi, 22.8% me rendësi, për 23.9% me shumë rendësi dhe për 18.5% si gjë e dëshirueshme. Afërsia e objekteve tjera kulturore konsiderohet nga 38.3% si me rendësi, 30.9% me shumë rendësi dhe nga 21.3% e dëshirueshme dhe pa rendësi fare konsiderohet për 9.5%. Që hapësira të jetë në një vend me të frekuentuar nga njerëzit, 25.8% e konsiderojnë me rendësi, 50.5% me shumë rendësi, 14% e konsiderojnë të dëshirueshme dhe 9.7% e shohin të pa rendësi. Afërsia me qendër të qytetit konsiderohet për 35.1% me rendësi, për 46.8 me shumë rendësi, për 11.7 e dëshirueshme dhe për 6.4% e pa rendësi. Që hapësira të ketë një qasje të lehtësuar, 34% e konsiderojnë me rendësi, 55.3% me shumë rendësi, 7.4% të dëshirueshme dhe 3.2 konsiderojnë se është pa rendësi. Parkingu dhe hapësirat përcjellëse për 39.4% konsiderohen me rendësi, për 35.1% me shumë rendësi, 22.3% të dëshirueshme dhe për 3.2 të parëndësi. Afërsia e hapësirës kulturore me objekte hoteliere konsiderohet nga 40.9% e parëndësi, 30.1% me rendësi, 11.8% me shumë rendësi dhe 17.2% e dëshirueshme. Afërsia me qendër tregtare dhe komunitet të biznesit konsiderohet nga 34% pa rëndësi, me rendësi nga 19.1%, me shumë rendësi nga 16% dhe e dëshirueshme nga 30.9%. Infrastruktura e rregulluar (rruga, uji, rryma, interneti) konsiderohen nga 83% si shumë me rendësi, nga 11.7% me rendësi, 4.3% të dëshirueshme dhe vetëm 1.1% e konsideron pa rendësi.

Që hapësira kulturore të jetë në një lagje me vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore dhe vlera turistike, 7.4% e vlerësojnë si të pa rendësi, 27.7% si me rendësi, 35.1% me shumë rendësi, dhe 29.8% e dëshirueshme. Afërsia me institucionet e administratës publike konsiderohet të jetë pa rendësi për 28.7%, me rendësi për 29.8%, me shumë rendësi për 19.1% dhe e dëshirueshme për 22.3% të organizatave të anketuara.

## II. Planet

Parashikimet e organizatave për zhvillimet e tyre në 5 vitet e ardhshme kanë orientim të dukshëm zhvillimor, 94.7% konsiderojnë se do të kenë shtim buxheti, vetëm 1.1% buxhet të njëjtë, 4.2% janë përgjigjur me 'nuk e di'. Po ashtu, për numrin e të punësuarve 92.6% presin rritje, vetëm 5.3% mendojnë se do të kenë numër të njëjtë të punëtorëve, dhe 2.1% janë përgjigjur me 'nuk e di'. 89.5% e organizatave deklarojnë qe do të kenë rritje të nevojave për hapësira kulturore dhe vetëm 10.5% konsiderojnë hapësirën aktuale si të mjaftueshme. Po ashtu, organizatat janë optimiste për sa i përket audiencës. 98.9% e tyre presin rritje të audiencës, vetëm 1.1% janë përgjigjur me 'nuk e di'. (Shih fig. A 53)




Fig. A 53




Fig. A 55

do të ndërmarrin ndonjë veprim tjetër (shih fig. A 55). 50.6% e organizatave aktualisht varen nga sigurimi i buxhetit dhe i lokacionit, 23.6% kanë filluar projektin e zgjerimit, 4.5% do të fillojnë një vit prej tani, 3.4% 2-3 vite prej tani, 1.1% brenda 5 viteve dhe 16.9% nuk kanë ndonjë afat të caktuar kohor. (shih fig. A 56)




Fig. A 56

97.9% konsiderojnë që në 5 vitet e ardhshme do të kenë një shkallë të rritur të shërbimeve kulturore dhe vetëm 1.1% shprehet për ofertë të njëjtë dhe 1.1% shprehet me 'nuk e di'. Zgjerimi i hapësirave ekzistuese apo krijimi i hapësirave të reja për 85.1% konsiderohet si çelës për adresimin e kësaj çështjeje, 4.6% planifikojnë ndërrimin veprimtarisë, 5.7% krijimin e një organizate tjetër të re dhe 4.6%

Ndërtimi i ri për 42% konsiderohet si zgjidhje për sigurimin e hapësirave kulturore, ndërsa adaptimi i një objekti me një destinim tjetër paraprak konsiderohet si zgjidhje për 58% të organizatave.

Financimi i ndërtimit të hapësirave të reja duket të jetë sfida

kryesore. Fushatat për grumbullim të fondeve konsiderohen të rëndësishme për 63.6%, ndërsa 75% e të anketuarve mendojnë se nuk është e mundur të behët financimi i ndërtimit me fondet ekzistuese, 88.6%. nuk e shohin si zgjidhje marrjen e kredisë. 21.6% nga organizatat e anketuara 78.4% janë në kërkim të ndonjë partneri afarist. Nga numri i organizatave që planifikojnë zgjerim në 5 vitet e ardhshme 96.6% aktualisht nuk kanë zgjidhje dhe vetëm 3.4% kanë një zgjidhje të caktuar (shih fig. A 62).




Fig. A 62

Nga viti 2000, 65.9% nuk kanë ndërmarrë asnjë investim kapital për rritjen e kapaciteteve të hapësirave kulturore, vetëm 34.1% kanë ndërmarrë aktivitete të tilla. 33.3% kanë nevojë për rritje të hapësirave për prezantim dhe ekspozim, 55.9% nga të gjitha organizatat e anketuara shprehin nevojën për rritjen e hapësirave për shfaqje, produksion. Rritja e hapësirave për ushtrime dhe përgatitje të produktit kulturor konsiderohet e nevojshme nga 57% e organizatave. Rritja e hapësirave për nevoja festive konsiderohet e domosdoshme për 66.7%. Nevoja për rritjen e hapësirave për arkivim dhe ruajtje të koleksioneve kulturore konsiderohet e rëndësishme për 48.4% të organizatave. Shtimi i hapësirave kulturore nën qiell të hapur (open-air) vlerësohet si pozitive për 48.4%. Zgjerimin e hapësirave administrative dhe përmirësimin e tyre 37.6% e konsiderojnë me rendësi, ndërsa 62.4% nuk e shohin si të domosdoshëm. Nevojën për rritjen e hapësirës së studiove individuale 52.7% të organizatave nuk e shohin si të domosdoshme. Po ashtu, hapësirat për veprimtari të specializuara si studio të incizimit, fotografimit, konsiderohen si të nevojshme për 26.9%, rritjen e hapësirave për trajnime dhe punëtori e preferojnë 33.3%, rritjen e klasave, sallave për ushtrime e preferojnë 51.6%. Nevojën

për vendparkime dhe objekte përcjellëse e shprehin 38.7%.




Fig. A 66

Hapësira minimale për të cilën organizatat kanë nevojë urgjente është 100-200 m<sup>2</sup> për 42% të organizatave, 201-300 m<sup>2</sup> 19.3% e organizatave, 3001-500 m<sup>2</sup> 15.9% e organizatave, 5001-1000 m<sup>2</sup> 13.6% e organizatave, 1001-5000 m<sup>2</sup> 8% e organizatave, 5001-10000 m<sup>2</sup> 1.1% e organizatave (shih fig. A 66).

### III. Hapësirat kulturore në dispozicion nëpër qytete

Aktualisht, 69.2% e organizatave i kanë teatrot e qytetit në dispozicion, 50% e tyre kanë kinema, shtëpitë e kulturës konsiderohet të jenë në dispozicion për 72.3%, qendrat e rinisë për 63.8%, bibliotekat për 84%, studiot e ndryshme artistike për 45.7%, hapësirat për performansa për 40.4%, sallat koncertale për 38.3%, atelietë për 39.4%, sallat e konferencës për 40.4%, salla për trajnime për 50%, sheshet për 64.9%, rrugët e përshtatshme për aktivitete nën qiell të hapur për 51.1%, parqet për 61.7%, qendrat rekreative për 39.4%, media qendrat për 27.7%, galeritë e

arteve për 42.6%, qendrat kulturore të komuniteteve për 25.5% dhe 3.2% e organizatave kanë në dispozicion edhe lloje tjera të hapësirave kulturore.




Fig. A 69

mal, 6.4% deklarojnë që hapësirat publike shfrytëzohen vetëm për data të shënuara dhe 1.1% konsiderojnë se ato janë jashtë përdorimit. Në çdo komunë ka hapësira të cilat mund të adaptohen në hapësira kulturore. 47.3% e organizatave kanë identifikuar 1-3 hapësira të mundshme të këtilla në komunën e tyre, 18.3% kanë identifikuar më shumë se 3 hapësira të mundshme, 14% konsiderojnë që nuk ka hapësira që mund të adaptohen, 16.1% nuk kanë informacion, 4.3% deklarohen se nuk e preferojnë adaptimin e hapësirave alternative në hapësira kulturore.

Debati qytetar për hapësirat kulturore në nivel komunal, sipas 20.7% e organizatave të anketuara është hapur dhe ende vazhdon, sipas 18.5% debati është iniciuar por nuk vazhdon, 19.6% deklarojnë se kjo temë nuk është trajtuar asnjëherë si çështje e politikave kulturore, 22.8% deklarojnë që debati zhvillohet vetëm në komunitetin e artisteve dhe qarqet joformale, 16.3% nuk kanë informata dhe 2.2% konsiderojnë që kjo çështje nuk është me rëndësi.

Rritja e kapacitetit të hapësirave kulturore duhet të mbështetet nga qeveria apo ministria e kulturës, sipas 98.9% e organizatave dhe nga komunat sipas 94.7% e organizatave. Kompanitë private dhe komunitetin e biznesit në këtë kontekst e shohin të rëndësishëm 35.1% e organizatave. Që zgjidhja mund të gjendet nga një partneritet i gjerë publik-privat mendojnë 23.4% e organizatave. Një partneritet ndërqeveritar konsiderohet i rëndësishëm nga 16%. Organizatat joqeveritare mund të ndihmojnë sipas 9.6% dhe 2.1% nuk kanë qëndrim të caktuar në lidhje me këtë.

#### IV. Veprimet më të rëndësishme që mundësojnë zgjerimin e hapësirave kulturore në Kosovë

Zhvillimi i programeve qeveritare për hapësirat kulturore konsiderohet i rëndësishëm për 84.9% të organizatave. funksionalizimi i hapësirave ekzistuese në pronësi publike dhe dedikimi i tyre për zhvillimin e aktiviteteve kulturore konsiderohet e rëndësishme për 77.4% të organizatave. Mbrojtja e destinimit të hapësirave kulturore në procesin e privatizimit konsiderohet e rëndësishme për 62.4%. Ndarja e granteve qeveritare për rritjen/shtimin e hapësirave kulturore konsiderohet e rëndësishme për 72%.

Ndërtimi i objekteve të reja konsiderohet i rëndësishëm për 65.6%, menaxhimi i kombinuar qeveritar-joqeveritar konsiderohet i rëndësishëm për 52.7%. Krijimi i një inventari të përgjithshëm për numrin dhe gjendjen e hapësirave kulturore në nivel komunal dhe qendror konsiderohet si veprim i nevojshëm për 50.5% të organizatave. Adaptimi i objekteve dhe gjetja e hapësirave alternative për veprimtari kulturore konsiderohet e rëndësishme për 46.2% të të anketuarve. Inkurajimi i komunitetit të biznesit për të investuar në shtimin e hapësirave kulturore vlerësohet nga 45.2% e organizatave. Investimi i shtuar në krijimin e hapësirave nën qiell të hapur si parqe, sheshe, rrugë etj. vlerësohet nga 43%. Krijimi i një politike fiskale miqësore për hapësirat me destinim kulturor konsiderohet e rëndësishme për 41.9%. Zhvillimi i partneritetit publik-privat vlerësohet si i rëndësishëm nga 40.9% e organizatave. Menaxhimi i kombinuar qeveritar(publik) dhe privat konsiderohet i rëndësishëm 34.4% e organizatave. Menaxhimi i hapësirave kulturore nga OJQ-t dhe agjencitë private vlerësohet nga 30.1%. Shtimi i ditëve të aktiviteteve në hapësirat kulturore ekzistuese konsiderohet si i nevojshëm nga 33.3% e organizatave. Përcaktimin e parimeve kryesore për subvencionimin e hapësirave kulturore 36.6% e konsiderojnë të rëndësishëm. Krijimin e komiteteve dhe këshillave përkrahës e konsiderojnë të rëndësishëm 34.4%. Menaxhimi i plotë i hapësirave kulturore nga komunat, shihet si i rëndësishëm nga 22.6%. 96.8% të organizatave konsiderojnë që këto janë veprimet më të rëndësishme që mundësojnë zgjerimin e hapësirave kulturore.

#### V. Cilët muaj gjatë vitit organizatat kulturore ofrojnë aktivitete kulturore? (Orari)




Fig. A 75

Gjatë muajit janar 62.1% e organizatave ofrojnë përmbajtje kulturore, në shkurt 58.9%, në mars 70.5%, në prill 72.6%, në maj 74.7%, në Qershor 72.6%, në Korrik 38.9%, në Gusht 34.7%, në Shtator 68.4%, në Tetor 66.3%, në Nëntor 75.8% dhe në Dhjetor 65.3%.

Shumica e organizatave të intervistuar ofrojnë përmbajtje kulturore më shpesh se një ditë në javë, 46.1% 3-5 ditë në javë, 36.8% tërë javën dhe 17.1% një ditë në javë. (shih fig. A 75).

16.5% e organizatave ofrojnë 2-4 orë në ditë program në hapësirat e tyre, 15.4% 4-6 orë në ditë, 44% 6-12 orë në ditë, 3.3% 12-16 orë në ditë në dispozicion të publikut dhe 20.9% deklarojnë nuk kanë një orar të rregullt.

(shih fig. A 76)




Fig. A 76



Kapaciteti aktual i hapësirave kulturore për 31% të organizatave është deri në 50 veta, për 19% 51-100 veta, për 10.7% 101-200 veta, për 26.2% është 201-500 veta, për 3.6% është 501-1000 veta dhe për 9.5 është mbi 1000 veta.

## VI. Gjendja e artistëve

Edhe pse 74% të artistëve të anketuar deklarojnë që kanë hapësirë ku mund të krijojnë dhe ushtrojnë veprimtaritë e tyre artistike, përqindja e të ardhurave nga kjo veprimtari është nën 50% tek 75.8% e artistëve. Më se 35.6% e artistëve të intervistuar sigurojnë më pak se 10% të të ardhurave të tyre nga veprimtaria artistike, 17.2% e artistëve i sigurojnë 10-25%, 23% prej tyre sigurojnë 25-50%, 13.8% e artistëve sigurojnë 50-70%, 3.4% e tyre sigurojnë nga 70-90% dhe vetëm 6.9% sigurojnë 100% të të ardhurave të veta nga veprimtaria artistike. (shih fig. B 6)




Fig. B 6




Fig. B 8

Më se 54.9% e artistëve të intervistuar kanë hapësirë pune në pronësi të vetën, 36.6% të huazuar/me qira dhe 8.5% kanë një zgjidhje tjetër. (shih fig. B 8)

Nga numri i përgjithshëm i artistëve që kanë atelie, 55.7% atelienë e kanë në shtëpinë e tyre, 29.5% e kanë më afër se 3 km nga shtëpia e tyre, 11.5% kanë atelie me larg se shtëpia dhe 3.3% kanë një situatë tjetër. 62.7% e tyre disponojnë me

një hapësirë nën 50 m<sup>2</sup>, 26.9% kanë 50-100 m<sup>2</sup>, 6% kanë 100-200 m<sup>2</sup>, 4.5% kanë 200-500 m<sup>2</sup> (shih fig. B 10).




Fig. B 10




Fig. B 12

artistike, për 14.3% përbejnë 6-10%, për 7.1% përbejnë 11-15%, për 9.5% përbejnë 16-20%, për 7.1% përbejnë 21-25%, për 11.9% përbejnë 26-35% dhe për 9.5% përbejnë 36-50% të shpenzimeve totale të veprimtarisë artistike.

Edhe pse të hyrat nga veprimtaria artistike për 75.8% paraqesin më pak se 50% e të hyrave totale, 75% e artistëve konsiderojnë që qiraja aktuale është e përballeshme me të hyrat, kushtet dhe perspektivën që e ofron hapësira. Ndërsa 25% e tyre e konsiderojnë si të papërballeshme qiranë.

Mesatarisht, hapësira aktuale shfrytëzohet nga 7.11 persona, ku 82.1% prej tyre janë të profilit të ngjashëm dhe merren me veprimtari të njëjtë, kurse 17.9% merren me veprimtari të ndryshme. Gjatë ditës në atelienë apo studion e tyre kalojnë 2-4 orë në ditë 43.8% e artistëve, 4-6 orë në ditë 28.1% e artistëve, 6-12 orë në ditë 9.4% e artistëve, 12-16 orë në ditë 6.3% e artistëve dhe 12.5% e tyre deklarojnë që nuk kanë një orar të rregullt. (shih fig. B 20)

Mesatarja mujore e shpenzimeve tjera për mirëmbajtjen e hapësirës është 205.9 €.




Fig. B 20

Pjesa më e madhe e artistëve që shfrytëzojnë hapësira me qira kanë kontratë vjetore. 13.2% e përtërijnë kontratën çdo muaj, 7.9% çdo tre muaj, 57.9% e përtërijnë kontratën çdo vit, 2.6% kanë kontratë prej 5-10 vite, 18.4% kanë kontratë mbi 10 vite.

Skadimi i kontratës për shfrytëzimin e hapësirës për 17.6% të artistëve është brenda 6 muajve, për 35.3% është 6 muaj-1 vit nga tani, 8.8% 1-2 vite nga tani, për 2.9% 3-5 vite nga tani dhe 35.3% pas 5 viteve. (shih fig. B 12)

Më se 13% e artistëve të intervistuar janë mbi 20 vite në hapësirën aktuale, 10.9% janë nga 16-20 vite, 4.3% nga 11-15 vite, 10.9% nga 6-10 vite, 28.3% 3-5 vite, 17.4% 1-2 vite, 15.2% më pak se një vit.

Shpenzimet e qirasë për 40.5% të artistëve përbejnë 1-5% të shpenzimeve totale të veprimtarisë

Shumica e hapësirave ku ata punojnë, 72.3% janë në qendër të qytetit, 24.6% në periferi dhe 3.1% në një zonë tjetër. (shih fig. B 21)




Fig. B 21

Artistët e pakënaqur me hapësirën aktuale përbejnë 10.6% të të anketuarve, 51.5% janë pjesërisht të kënaqur, 27.3% të kënaqur dhe 10.6% shumë të kënaqur.

## VII. Veprimet e domosdoshme për përmirësimin e hapësirave kulturore

Nga perspektiva e artistit, mbrojtja e destinimit të hapësirave kulturore konsiderohet, për 92.2% si me shumë rëndësi, për 6.7% me rëndësi, e dëshirueshme për 1.1% të artistëve të intervistuar. Ndarja e granteve qeveritare për rritjen/shtimin e hapësirave kulturore konsiderohet për 85.2% me shumë rëndësi, për 14.8% me rëndësi.

Zhvillimi i programeve qeveritare për shtimin e hapësirave kulturore për 83.3% konsiderohet si shumë me rëndësi, për 12.2% me rëndësi, për 4.4% i dëshirueshëm.

Funksionalizimi i hapësirave ekzistuese në pronësi publike dhe të dedikuara për aktivitete kulturore nga 74.4% e artistëve konsiderohet me shumë rëndësi, nga 23.3% konsiderohet me rëndësi dhe nga 2.2% i dëshirueshëm. Ndërtimi i objekte të reja është më shumë rëndësi për 73% të artistëve të anketuar, me rëndësi për 15.7%, i dëshirueshëm për 9% dhe i parëndësishëm për 1.1% të tyre.

Zhvillimi i partneritetit publik-privat dhe inkurajimi i komunitetit të biznesit për rritjen/shtimin e hapësirave kulturore, 8.9% e artistëve e shohin më shumë rëndësi, 23.3% me rëndësi dhe 7.8% si të dëshirueshëm. Zhvillimin e një politike fiskale miqësore për hapësirat me destinim kulturor, 67.8% e shohin me shumë rëndësi, 25.6% me rëndësi, 5.6% të dëshirueshme dhe 1.1 si të parëndësi.

Adaptimi i hapësirave dhe objekteve të mundshme për veprimtari kulturore konsiderohet me shumë rëndësi për 66.7% të artistëve, me rëndësi për 25.6%, si i dëshirueshëm për 6.7% dhe për 1.1% konsiderohet i parëndësi.

Krijimi i një inventari të përgjithshëm për numrin dhe kapacitetin e hapësirave kulturore në nivel komunal dhe në nivel shtetëror, konsiderohet nga 66.3% me shumë rendësi, 25.8% me rendësi dhe 7.9% si veprim i dëshirueshëm. Krijimin e komiteteve dhe këshillave përkrahës dhe përcaktimin e kriterëve kryesore për subvencionimin e organizatave për shtimin e hapësirave kulturore, 66.3% e artistëve e shohin si shumë me rendësi, 20.2% me rendësi, 11.2% të dëshirueshëm dhe 2.2 pa rendësi. Shtimi i ditëve (aktiviteteve) aktive në hapësirat kulturore ekzistuese konsiderohet nga 53.9% si me shumë rendësi, nga 37.1% me rendësi, i dëshirueshëm nga 7.9% dhe i parëndësi nga 1.1 i artistëve të anketuar.

Menaxhimi i kombinuar qeveritar dhe joqeveritar i hapësirave kulturore për 46.1% konsiderohet si me shumë rendësi, 38.2% me rendësi, 14.6% i dëshirueshëm dhe 1.1% i parëndësi. Menaxhimi i kombinuar qeveritar (publik) dhe privat për 46.1% të artistëve konsiderohet me shumë rendësi, për 32.6% me rendësi, për 15.7% i dëshirueshëm dhe i parëndësi për 5.6% të artistëve të anketuar. Menaxhimi i përbashkët nga OJQ-t dhe agjencitë private, për 37.1% të artistëve të anketuar konsiderohet si me shumë rendësi, për 30.3% me rendësi, për 24.7% e konsiderojnë si veprim të dëshirueshëm dhe 7.9% e konsiderojnë të parëndësi. Menaxhimi i plotë i hapësirave kulturore nga komuna, konsiderohet nga 18.2% e artistëve si me shumë rendësi, nga 33% me rendësi, nga 18.2% i dëshirueshëm dhe si i parëndësi konsiderohet nga 30.7% e artistëve të anketuar.

Që në hapësirat kulturore të mundësohet qasja e personave me aftësi të kufizuara, 70.8% e artistëve e konsiderojnë si me shumë rendësi, 22.5% me rendësi dhe 6.7% si veprim të dëshirueshëm.

Nga 13 karakteristikat e paraqitura në pyetësor 5 prej tyre shquhen për nga preferenca e artistëve:

		%
1	<b>Ujë dhe rrymë pa ndërprerje</b>	<b>82.0</b>
2	<b>Ndriçim natyror</b>	<b>60.2</b>
3	<b>Izolim Akustik</b>	<b>58.4</b>
4	<b>Nxehje qendrore</b>	<b>50.6</b>
5	<b>Ambient i qetë/larg qasjes për publikun</b>	<b>49.4</b>
6	Me mure të larta	42.7
7	Qasje fleksibile	40.4
8	Qasje për publikun	38.2
9	Me hapësira ndihmëse	34.8
10	Ventilim të mirë	34.8
11	Qasje për vetura	18.0
12	Qasje në internet	13.5
13	Siguri të shtuar/dyer të blinduara	6.7

Është indikative karakteristika 'siguria e shtuar' e cila paraqitet në fund të listës së preferuar për atelienë ose për artistin me vetëm 6.7%.

## VIII. Llojet e hapësirave për të cilat kanë nevojë artistët.

Për salla konference apo salla takimesh vetëm 7.9% e artistëve deklarojnë që kanë nevojë për to, 42.7% deklarojnë se kanë nevojë për hapësira prezantimesh/ekspozitash, 43.8% hapësira për shfaqje teatrale/performasa, 46.1% hapësira për ushtrime, 32.6% hapësira për ngjarje festive, 27% hapësirë arkivore/muzeu, 32.6% hapësira nën qiell të hapur, 11.2% hapësira administrative, 38.2 hapësira për studio individuale, 36% hapësira për veprimtari të specializuara (studio incizimi, fotografimi, qeramike etj.), 37.1% hapësira për trajnime dhe organizim të punëtorive, 22.5% klasa dhe salla ushtrimesh, 12.4% vend-parkime dhe objekte ndihmëse.

Artistët preferojnë hapësira pune në pronësi private 44.2% dhe hapësira në pronësi të komunës të hapura për artistë 45.3%, hapësirat me qira (shfrytëzim individual) 3.5% dhe hapësirë me qira e kufizuar (shfrytëzim i përbashkët 2-3 veta) 7.0%. 11.6% e artistëve konfirmojnë se debati për hapësirat kulturore në qytetin e tyre është i hapur dhe ende vazhdon, 58.1% thonë që nuk kemi një debat të tillë, dhe 30.2% thonë 'nuk e di'. (shih fig. B 44)




Fig. B 44

Platforma "Culture 2013" përkrahët nga Olof Palme International Centre që financohet nga SIDA (Swedish International Development Agency)



This document has been financed by the Swedish International Development Cooperation Agency, Sida. Sida does not necessarily share the views expressed in this material. Responsibility for its contents rests entirely with the author.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë pasqyrë e deklaramit të të intervistuarve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Platformës "Culture 2013", gjegjësisht subjekteve që e përbëjnë atë dhe donatorëve.